



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROCESVERBAL NR. 3**

Rrogozhinë, më 31.07.2023 ora 09 : 00<sup>oo</sup>

Zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

**Rendi i ditës :**

Në mbështetje të shkresës “Njoftim”, të Kryetares së Këshillit Bashkiak me Nr.2622.Prot datë 26.07.2023 si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.2, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 30.06.2023.
- 3- Dhënia e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak znj. Lije Dedej.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2023 nga fondi i Bllok - Ndhmës 6%”.
- 5- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2023 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 6- Të ndryshme.
  - *Shqyrtim i kërkesës për ndihmë të menjëhershme ekonomike.*
  - *Të tjera.*

**Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :**

Hekuran Xhani, Silvana Aliu, Indrit Dedej, Bajazit Thaçi, Saimir Cani, Sokol Gosa, Fatbardha Sina, Altin Tosku, Lulzim Hasa, Gezime Met-hasani, Alime Hoxha, Lije Dedej, Mukades Gixhari.

**Mungojnë :**

Shpati Kolgega, Renato Kalemi, Fatmira Thartori, Enver Memolla, Erind Tosku, Besnike Coraj, Ferdi Avdiu, Mitat Daja.



### **Të ftuar :**

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Rezart Vogli - Drejtor i Financës.
3. Helidon Plaku - Drejtor Juridik dhe marrëdhënieve me Publikun.
4. Fatmir Meçaj - Drejtor i Arsimit, Sportit, Kulturës, Turizmit.
5. Orges Tosku - Drejtor i të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
6. Olsi Dranga - Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse.
7. Elona Kacani - Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore.
8. Ledian Hasani - Përgjegjës i Shërbimit Social.
9. Ramazan Sula - Përgjegjës i zyrës së punës Rrogozhinë.
10. Mario Meka - Përgjegjës i zyrës IT.
11. Sidorela Troka - Specialiste Juriste.

### **Drejtton mbledhjen :**

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

- Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm gjithsej 12 Këshilltarë.

## **HAPET MBLEDHJA**

**Mukades Gixhari** . Përhëndetje të nderuar Këshilltarë! Meqë e kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur!

Marrin pjesë në mbledhje këshilltarët : z. Hekuran Xhani, znj. Silvana Aliu, z. Indrit Dedej, z. Bajazit Thaçi, z. Saimir Cani, z. Sokol Gosa, znj. Fatbardha Sina, z. Altin Tosku, z. Lulzim Hasa, znj. Gezime Met-hasani, znj. Alime Hoxha dhe Mukades Gixhari.

Kalojmë në leximin e verifikimit ligjor ardhur nga Prefekti i Qarkut Tiranë për Vendimet e Këshillit Bashkiak të datës 30.06.2023. Për sa më sipër:

Vendimi nr .7, datë 30.06.2023 “Për pranimin e dorëheqjes nga mandati i Këshilltarit për



Këshillin Bashkiak Rrogozhinë të znj. Sadete Kaja” është në përputhje me ligjin.

Vendim nr .8. datë 30.06.2023 “Për miratimin e komisioneve të përhershme të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë” është në përputhje me ligjin.

Vendim nr .9. datë 30.06.2023“Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Maj 2023 nga fondi i Bllok – Ndhmës 6%” është në përputhje me ligjin.

Vendim nr .10. datë 30.06.2023 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2023 nga fondi i pushtetit vendor” është në përputhje me ligjin.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin Prefekti Afrim Qendro.

Po ndjesë për vendimin nr.7, datë 30.06.2023 “Për pranimin e dorëheqjes nga mandati i Këshilltarit për Këshillin Bashkiak Rrogozhinë të znj. Sadete Kaja” është lapsus i Prefekturës unë po e korigjoj (nga Hoxha në Kaja) ta kemi ne në rregull.

Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës. Miratimi i rendit të ditës. Jeni dakord për rendin e ditës? e hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Vota ime shkon pro. Miratohet.

*-Miratohet me 12-vota pro pika 1 (një) e rendit të ditës.*

**Mukades Gixhari** . Kalojmë në pikën e dytë. Miratim i procesverbalit Nr.2, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 30.06.2023. E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

*-Miratohet me 12-vota pro pika 2 (dy) e rendit të ditës.*

**Mukades Gixhari** . Kalojmë në pikën tre “Dhënia e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak znj. Lije Dedej”. Kam raportin e komisionit të mandateve që : Propozon dhënien e mandatit të znj. Lije Dedej. Atëherë para se ta hedhim në votim kalojmë në procedurën e bërjes së betimit. Mund të ngriheni znj. Lije.

Betohem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të këshillit bashkiak dhe do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të bashkisë Rrogozhinë dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqënies së tyre.

Betohem.

**Lije Dedej** . Betohem.

**Mukades Gixhari** . Urime! Tani kalojmë në votim për dhënien e mandatit të Këshilltares znj. Lije Dedej. E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.



*-Miratohet me 12-vota pro pika 3 (tre) e rendit të ditës.*

**Vendim nr .11.** Miratohet me 12 vota pro, propozimi i Komisioni të Mandateve, “Për dhënien e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë znj. Lije Dedej”.

**Mukades Gixhari .** Kalojmë në pikën 4, Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2023 nga fondi i Bllok - Ndhmës 6%”. Për gjegjësi i Shërbimit Social z. Ledian Hasani. z. Ledio përshëndetje, fjala për ju!

**Ledian Hasani .** Në total janë 21 familje përfituese me një fond prej 87 mijë lekësh të reja.

**Mukades Gixhari .** Secili nga ju e ka letrën përpara në qoftë se a ndonjë gjë rreth kësaj pike. Po z. Indrit.

**Indrit Dedej .** Emrat ku janë?

**Ledian Hasani .** Janë familje që kanë aplikuar tek ndihma ekonomike dhe nuk kanë dalë përfitues.

**Mukades Gixhari .** E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

*-Miratohet me 13-vota pro pika 4 (katër) e rendit të ditës.*

**Vendim nr .12.** Miratohet me 13 vota pro, projekt-vendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.2563.Prot datë 19.07.2023 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2023 nga fondi i Bllok – Ndhmës 6% “.

**Mukades Gixhari .** Kalojmë në pikën 5, “Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2023 nga fondi i pushtetit vendor”. Vazhdojmë po me z. Ledian Hasani.

**Ledian Hasani .** Në total janë 14- familje përfituese dhe fondi është 53 mijë lekë të reja.

**Mukades Gixhari .** Ndonjë diskutim rreth kësaj pike? Atëherë e hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

*-Miratohet me 13-vota pro pika 5 (pesë) e rendit të ditës.*



**Vendim nr .13.** Miratohet me 13 vota pro, projekt-vendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.2641.Prot datë 27.07.2023, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2023 nga fondi i pushtetit vendor“.

**Mukades Gixhari .** Faleminderit z. Ledian. Kalojmë në pikën 6-të të rendit të ditës. Të ndryshme. Shqyrtim i kërkesës për ndihmë të menjëhershme ekonomike. Kemi një kërkesë: Unë i nënshkruari Blerim Danushi banor i Lagjes nr.2, Rrogozhinë paraqes kërkesën time si më poshtë :

Prej 9-të vitesh nëna ime është shumë e sëmurë vuan nga skleroza dhe tromboza celebrale, por prej gati 2 vitesh e gjysmë kam shumë sëmurë edhe motrën time e cila vuan nga ciroza në mushkëri këtë jua vërtetoj dhe me diagnozat e mjekut, bashkëngjitur kësaj kërkesë.

Jemi familje në gjëndje shumë të vështirë ekonomike dhe për këtë arsye kërkoj nga kryetari i bashkisë dhe këshilli bashkiak të më ndihmojë me një ndihmë të menjëhershme ekonomike. Mbetem në pritje të miratimit të kësaj kërkesë nga ana juaj.

Kemi drejtorin e financës këtu z. Rezart Vogli. Ju e njihni personalisht?

**Rezart Vogli .** Ka arsye për çfarë e kërkon ndihmën?

**Mukades Gixhari .** Nëna dhe motra dy pjesëtarë të familjes janë sëmurë.

**Rezart Vogli .** Jam i njohur me rastin ka ardhur në Bashki është ankuar disa herë ka familjarët e sëmurë. Shiheni vetë Bashkia e ka mundësinë referuar rasteve të mëparshme 30-50 mijë lekë të reja.

**Hekuran Xhani .** Çfarë do bëjë me 30-mijë lekë ai?

**Rezart Vogli .** Nëse ka shumë nga ne që e njohin aq më mirë.

**Hekuran Xhani .** Tani ne qenkemi shumë të vonuar. Këshilli i mëprashëm sepse shteti prandaj funksionon duke i ardhur në ndihmë njerëzve. Ju e njihni si rast unë jam plotësisht dakord të marri vlerën maksimale 50-mijë lekë në muaj. As nuk e njoh por përderisa ka sjellë dokumentacionin. Unë jam dakord thashë me 50-mijë lekë të reja në muaj.

**Alime Hoxha .** Prit njëherë. A ka mundësi Bashkia të japë 50-mijë lekë të reja në muaj?

**Hekuran Xhani .** A the 30 deri 50?



**Alime Hoxha** . 30-50 jepen një herë jo çdo muaj. Një ndihmë është.

**Lulzim Hasa** . Një ndihmë e menjëhershme është.

**Rezart Vogli** . Raste të tilla në 4 vite do keni shumë.

**Hekuran Xhani** . Po pas 1 muaji do shërohen këta?

**Alime Hoxha** . Jo ato nuk do shërohen por mundësitë e Bashkisë mesa dimë nga rastet e tjera që kemi kaluar japin vetëm një ndihmë 50 mijë lekë.

**Hekuran Xhani** . Çfarë mundësie ka Bashkia?

**Alime Hoxha** . Se çfarë mundësie ka Bashkia flet vetë drejtori.

**Hekuran Xhani** . Shteti jo në Shqipëri por në gjithë botën funksionon më shumë se të aftët mbijetojnë vetë s'kanë shumë nevojë për shtetin. Pra nevojtarët për shtetin janë të gjithë ata që janë të paaftë për të konkuruar dhe për të jetuar.

**Alime Hoxha** . Të lutem më fal nuk kam asgjë kundra në qoftë se ka mundësi Bashkia të japë 50- mijë lekë muaj për muaj le të ja japë.

**Hekuran Xhani** . Unë kam punuar në Këshill prandaj po them jo pak por 8 vjet sekretar këshilli.

**Alime Hoxha** . Nëse e ka mundësinë Bashkia për mua të ja japë 50 mijë lekëshin çdo muaj por unë di nga...

**Rezart Vogli** . Jo, çdo muaj. Ajo thotë ndihmë financiare e menjëhershme jepet vetëm njëherë.

**Silvana Aliu** . Nga Bashkia merr gjë?

**Rezart Vogli** . Patjetër që merr, merr KEMP patjetër. Gjatë 4 vjeçarit do keni shumë raste të tilla. Nëse bini dakord si Këshill Bashkiak mbledhjen e ardhshme unë si drejtor finance sjell projekt vendimin .

**Mukades Gixhari** . Projektvendim se kjo është një kërkesë.



**Hekuran Xhani** . Ato kanë nevojë emergjente është rast emergjent. Zotëri sa më shpejt brenda kompetencave ligjore t'i shkojë një ndihmë në emër të pushtetit asaj atje. Mos përdorni...

**Rezart Vogli** . Është një projektvendim që miratohet në Këshillin Bashkiak.

**Hekuran Xhani** . Ne jemi dakord e miratojmë sot dhe vazhdo procedurat ... ai pas një muaji do lekët. Do vijë muajin tjetër projekt . Në moment që këshilli merr vendim.

**Rezart Vogli** . Vendimi i këshillit mori parasysh kërkesën e zotërisë.

**Mukades Gixhari** . Miraton kërkesën e zotërisë sepse kështu funksionon.

**Rezart Vogli** . Vetëm shkresë nuk e miraton askush.

**Hekuran Xhani** . Në moment që Këshilli merr vendim sekretari zbardh vendimin konfirmon prefekti. Vendimi është i detyrueshëm për t'u zbatuar.

**Rezart Vogli** . Kemi projekt përpara ne sot?

**Hekuran Xhani** . Kam një kërkesë unë projektvendim është ky zotëri, a po marr vendim unë për atë familje.

**Mukades Gixhari** . Nuk e firmosim dot sot se nuk e kemi projektvendimin përpara.

**Hekuran Xhani** . Kush do e bëjë projektvendimin?

**Mukades Gixhari** . Zotëria (i referohet drejtorit të financës).

**Hekuran Xhani** . Pse duhet ta bëjë ai? Kryetare të lutem ky është vendim përderisa ai i drejtohet këshillit, ai sjell kërkesën këshilli me shumicë votash e miraton. Është vendim që nuk ka nevojë për projektvendim.

**Sokol Gosa** . Tani këto raste që do kemi dhe raste të tjera . Ai bën një kërkesë për ndihmë të menjëhershme shuma që u tha 30-50 për mua të jetë maksimalja një 50-mijë lekësh që atij mund t'i vijë sadopak në ndihmë. E para këtu besoj jemi të gjithë dakord dhe e dyta pastaj të diskutojmë projektvendimin që mund të bëhet për këtë person apo familje këto bëhen në të ardhmen, sot kalojmë vetëm këtë shumë .



**Rezart Vogli** . Ku është e shkruar shuma 50 mijë lekë ?

**Sokol Gosa** . E the ti.

**Hekuran Xhani** . E miratoi Këshilli.

**Rezart Vogli** . Duhet një projektvendim për të miratuar shumën. Ky është hapi i parë zotëria qytetari i drejtohet këshillit bashkiak, këshilli merr parasysht kërkesën dhe ja drejton zyrës përkatëse.

**Hekuran Xhani** . Këtu ka ardhur një kërkesë për fat të mirë është dhe shefi i financës, kjo kërkesë do miratohet në këshill sot. Unë nuk miratoj projektin që do sjellësh ti mua. Unë e miratoj sot dhe unë e mbyll kapitullin. Ti si administratë je i detyruar të zbatosh vendimin e këshillit bashkiak në rast se është në përputhje me ligjin po nuk ishte në përputhje me ligjin ta kthen mbrapsh Prefekti.

**Mukades Gixhari** . Ta dëgjojmë pak z. Lulzim Hasa meqë është këshilltar i vjetër.

**Lulzim Hasa** . Kryetare këtu vjen një kërkesë nuk del vendimi mbi kërkesën. Vendimet miratohen mbi projektvendimin , çdo projektvendim drejtohet me vendim ne miratojmë shumën maksimale familjet në nevojë drejtori sjell projektvendimin edhe e kalojmë në vendim. Si mund të bëhet kërkesa në vendim. A kemi projektvendime ne këtu, çfarë miratuam ne sot?  
- Projektvendim, i kthyer në vendime. Kur të sjelli drejtorin projektin kalojmë miratohet është ligjore.

**Hekuran Xhani** . Si është ligjore zotëri? I ka shkruar kërkesa këtij ? Sekretarit të këshillit i ka shkruar kërkesa. Do presim muajin tjetër të marri ndihmën. Në moment që këshilli merr vendim ky kthehet në vendim.

**Lulzim Hasa** . Është kështu autorizohet drejtori të bëjë projektvendimin dhe ai kalon në vendim, ka rrugë ligjore ai ka kaq vite që pret.

**Alime Hoxha** . Mund të bëjmë dhe një mbledhje jashtë radhe.

**Hekuran Xhani** . Kryetari duhet ta kishte sjellë projektin nëse i ka shkruar kërkesa. Në moment që këshilli i vjen kërkesë këshilli miraton kërkesën, kalohet në vendim i nderuar këshilltar i vjetër. Kur këshilli merr vendim kërkesa kthehet në vendim.





**Lulzim Hasa** . Këshilli procedon mbi projektvendime .

**Hekuran Xhani** . Hape ligjin.

**Lulzim Hasa** . Mbi projektvendime nuk miraton këshilli kërkesa ne miratojmë kërkesën autorizohet financa sjell projektvendimin dhe miratohet.

**Mukades Gixhari** . Nëse ne duam që ta ndihmojmë qytetarin e bëjmë një mbledhje jashtë radhe.

**Alime Hoxha** . Atëherë meqenëse se sot ka ardhur kërkesa, kjo kërkesë kalon nga këshilli për miratim ...

**Hekuran Xhani** . Jo këshilli e ka marr vendim jo miratim.

**Alime Hoxha** . Një minutë se duhet të mblidhet komisioni i ekonomisë që të mari vendim . Si mund të mblidhet komisioni i ekonomisë pa e kaluar në këshill atë. Ndoshta ti nuk do që ai ta marri ndihmën ekonomike.

**Hekuran Xhani** . Unë dua që ai ta marri.

**Alime Hoxha** . Nuk dua unë.

**Hekuran Xhani** . Ai qenka nga Rrogozhina unë nuk e njoh fare unë dëgjova Indritin edhe shteti funksionon në gjithë botën edhe njëherë po them zonjë për njerëzit në nevojë, kush është i aftë nuk ka nevojë për shtetin. Mua nuk më bie mendja fare ku është shteti apo çfarë bën shteti.

**Alime Hoxha** . Nuk ka nevojë t'i bërtasim njëri tjetrit nuk jam kundra të ndihmohen njerëzit në nevojë më kupto. Njerëzit në nevojë të ndihmohen por në bazë të ligjit. Tani ne sot kemi një kërkesë që ka ardhur në qoftë se këshilli e miraton atë kërkesë që ky person të trajtohet me ndihmë ekonomike të menjëhershme apo edhe një ndihmë tjetër të mblidhet komisioni i ekonomisë të marri një vendim ta sjelli në këshill dhe ta vendosim.

**Hekuran Xhani** . Ne morëm vendim ti thua ta marri sërish komisioni i ekonomisë. Ligjin e miraton parlamenti nuk e miraton qeveria ligjet.

**Alime Hoxha** . Parlamenti miraton ligjet që i vijnë nuk miraton kërkesa ligjet që i shkojnë projektligjet.



**Hekuran Xhani** . Projektligji është ky është kërkesë.

**Indrit Dedej** . Kryetari i Bashkisë nuk e bën kurrë atë projektvendim ...

**Hekuran Xhani** . Sot kërkesa është kthyer në vendim.

**Fatmir Meçaj** . Është bërë kërkesa dhe ajo çohet tek dikasteri që është përgjegjës për këtë punë. Çohet kërkesa dhe e shqyrton komisioni përkatës .

**Hekuran Xhani** . Çfarë po flet o burr shteti?! Kërkesa i është drejtuar sekretit të këshillit ai ka të gjithë kompetencat të ja çojë kryetarit zyrës së financës kur vjen kërkesa këtu ajo kthehet në vendim këshilli. Për çfarë votuam ne?

**Fatmir Meçaj** . Ti ke nga komisioni i ekonomisë një opsion ke? I pari i komisionit thotë kështu do vendoset.

**Hekuran Xhani** . Vendos Këshilli, çfarë komisioni procedura burokratike do ndjekim ne prapë. Të ja kthejmë këshillin qytetarëve e kam lënë atje jashtë unë tesian e partisë mbrapa derës, këtu jam për të mbrojtur interesin e qytetarëve, atje e kam lënë tesian.

**Alime Hoxha** . Pse të çojmë vendime që të na i kthejë prefekti mbrapsh. Nuk i marrim dot vendimet si duhet.

**Mukades Gixhari** . Ramë dakord të gjithë që do ta ndihmojmë me 50 mijë lekë të vjetra, a jeni dakord për këtë pjesë?

**Lulzim Hasa** . Kryetare për personin në fjalë të gjithë sa jemi , jemi dakord që të përfitojë ndihmë të menjëhershme me shumë maksimale 50 mijë lekë por të gjeni procedurën ligjore s'ka asnjë të keqe nuk e mori sot do e marri nesër.

**Hekuran Tosku** . Procedurat burokratike jo ligjore.

**Lulzim Hasa** . Kryetare ta votojmë mbledhjen tjetër të vijë projektvendimi.

**Ervis Shera** . Kjo është një kërkesë që i është drejtuar këshillit erdhi këtu e mori pëlqimin e këshillit Prefektura kërkon një projektvendim kërkon dhe një relacion shpjegues për këtë kërkesë. Relacionin do e bëjë përgjegjësi i shërbimit social, drejtoria e financës do thotë zërin



financiar. Drejtoria Juridike do thotë bazën ligjore dmth pa këto dy dokumente ne nuk marrim do vendim .

**Indrit Dedej** . Kjo zgjat një muaj.

**Ervis Shera** . Atëherë në qoftë se mblidhej komisioni në mënyrë të përshpejtuar komisioni nxirrte një projektvendim edhe ne e miratonim sot.

**Hekuran Xhani** . Do mbledhësh komisionin për strategjinë ekonomike të bashkisë nuk do merret komisioni me kërkesa që i ...

**Fatmir Meçaj** . Merret ...

**Hekuran Xhani** . Si merret ? Mbaje 6-muaj.

**Lulzim Hasa** . Zotëri po të kishte 5-6 kërkesa për ndihmë të menjëhershme nga këto do i japim të pesta ne? Do votohet kush e përfiton, kush e meriton dhe e kalojmë në projektvendim. Mund të kishim 10 kërkesa sot 10 vendime do marr menjëherë unë.

**Hekuran Xhani** . Merr vendim këshilli jo projektvendim në moment që ngrej dorën unë ka mbaruar është miratuar ligji në parlament.

**Lulzim Hasa** . Miraton kërkesën jo vendimin.

**Hekuran Xhani** . Mbi bazën e shpjegimit që dha specialisti i zyrës së financave mund të japë nga 30-50 mijë lekë të reja.

**Lulzim Hasa** . Ka firmosur gjë ai? Ke parë gjë të firmosë ai?

**Hekuran Xhani** . Ai na e shpjegoi.

**Lulzim Hasa** . Ai do e shpjegojë apo do e firmosi projektvendimin? Kryetare të lutem nuk mund të rrimë këtu e lagu se lagu se kështu vazhdon gjithë ditën ky muhabet.

**Hekuran Xhani** . Kështu do veprojmë ne? Hapni ligjin mësoni ligjin para se të vini në mbledhje.

**Lulzim Hasa** . Ti nuk e njeh fare ligjin.



**Silvana Aliu** . Rezi Bashkia Rrogozhinë e përballon këtë shumë, si mund ta ndihmojmë?

**Rezart Vogli** . Ne po flasim për një kërkesë për ndihmë të menjëhershme. U vonuat kot 4 vjet do kemi raste të tilla .

**Silvana Aliu** . Ne e njohim Rrogozhinën dhe e dimë që ky është një rast i veçantë.

**Rezart Vogli** . Edhe ne njohim letrat.

**Silvana Aliu** . Letrat po por ne po flasim për pjesën humane.

**Fatmir Meçaj** . Human pa letra nuk ka.

**Mukades Gixhari** . Jemi tek të ndryshme. Atëherë në mbledhjen e kaluar nga Këshilli u kërkuan disa informacione dhe u ngritën disa problematika të ndryshme, që kërkojnë angazhimin e administratës së bashkisë për zgjidhje sipas rastit. I marrim me radhë : Kërkesë për informacion. Drejtoria Juridike dhe Marrëdhënieve me Publikun. Sektorit të burimeve njerëzore. Znj. Elona Kacani do të na relatojë në lidhje me këtë. Sa është numri i punonjësve aktualë në Bashkinë Rrogozhinë?

**Silvana Aliu** . Të vijë drejtori se ashtu si e ka dhënë informacionin është sa për të kaluar radhën.

**Elona Kacani** . Përshëndetje të gjithëve ! Suksese për mandatin. Pyetjes se sa ishte numri i të punësuarve kemi 298 të punësuar përfshihet administrata dhe punonjësit që vijnë nga fondet e deleguara. Kjo është një e dhënë për muajin e kaluar Qershor 2023. Nëse ka ndonjë pyetje?

**Hekuran Xhani** . Kam unë një pyetje. Punëtorët me kontratë janë tek kjo lista, punonjësit sezonalë?

**Elona Kacani** . Jo nuk janë përfshirë sepse e kam shënuar këtë...

**Hekuran Xhani** . Se ka mundësi të jenë më shumë sezonalë se...

**Elona Kacani** . Jo, sezonalët janë më pak se 40 veta.

**Silvana Aliu** . Atëherë përse nuk janë dhënë emrat?



**Elona Kacani** . Nuk është kërkuar, kërkesa është numri total i punonjësve nuk thuhet lista e punonjësve të bashkisë Rrogozhinë.

**Silvana Aliu** . Ne kërkuam listën me emrat dhe çfarë punë bëjnë për t'i verifikuar nëse janë apo nuk janë.

**Elona Kacani** . Po, mund të paraqes edhe borderonë kush paguhet çdo muaj, emrat janë në bordero.

*-Largohet nga mbledhja Këshilltari z. Lulzim Hasa në minutën e 31 të zhvillimit të mbledhjes.*

**Silvana Aliu** . Po për Njësitë?

**Elona Kacani** . Numri është për njësitë për bashkinë personat që janë paguar në muajin Qershor 2023 janë 298 nëse doni paraqesim borderonë mbledhjen tjetër.

**Indrit Dedej** . Ndaje pjesën e pagave vetëm pagesën në bankë. Dhe të 6-muajve më parë.

**Elona Kacani** . E do të 6-muajve më parë? Pa problem për të bërë një krahasim sjellim Janarin.

**Mukades Gixhari** . Vazhdojmë me pyetjen e radhës. A janë punonjësit me vnedbanim në Bashkinë Rrogozhinë dhe sa efikasë janë në pozicionet e tyre të punës?

**Elona Kacani** . Jo të gjithë 100% nuk janë me vendbanim në Rrogozhinë por pjesa dërrmuese janë banues të Rrogozhinës. Shumë pak janë nga Kavaja, kryesisht janë specialistë që pavarësisht se ne kërkojmë punonjës, Rrogozhina nuk arrin dot që të mbulojë fusha specifike kështu që shumë pak janë edhe jashtë Rrogozhine. Ligji nuk është se përcakton se duhet të jenë se s'bën ...

**Alime Hoxha** . Këtë numrin se sa janë shumë pak e keni?

**Elona Kacani** . Jo nuk e kemi. Nuk është se ka ndonjë ndryshim se për 4 muaj kemi qenë në fushatë dhe nuk është se na lejohen punësimet kështu që pa problem jua sjellim.

**Alime Hoxha** . Nuk besoj se lejohet të dali borderoja.

**Silvana Aliu** . Nuk kërkojmë borderonë sa puguhen, emrat.



**Hekuran Xhani** . Borderoja ka emër, mbiemër dhe rrogën mujore ajo është shumë transparente me fjalën që po thotë vajza.

**Silvana Aliu** . Normalisht me rregullore nuk lejohet që paga të zbulohet.

**Alime Hoxha** . Po, publikimi i pagës nuk lejohet.

**Mukades Gixhari** . Kalojmë tek sugjerimi i radhës. Të shihet mundësia e rritjes së punonjësve sezonalë në nevojë në sektorin e turizmit më konkretisht në plazhin e Vilë-Bashtovës dhe Spillesë dhe sa është numri i tyre aktual.

**Elona Kacani** . Mund të flas vetëm për numrin aktual që është 19, pesëmbëdhjetë janë në Spille pjesa tjetër janë në Vilë- Bashtovë.Ndërsa për pjesën e mundësisë...

**Hekuran Xhani** . Shumica punojnë privat atje sepse kanë lidhur kontrata private, punojnë në të zezë.

**Altin Tosku** . Çfarë funksioni kryejnë këto në përgjithësi tek sezoni i plazhit?

**Elona Kacani** . Mirëmbajtje pastrim.

**Altin Tosku** . Po nga këto që janë për ruajtjen e vijës bregdetare?

**Elona Kacani** . Që rujanë vijën bregdetare jo, secili stacion plazhi ka vetë sepse ato kanë disa kritere...

**Altin Tosku** . Pse nuk duhet ta bëjë shteti këtë se është më e lehtë ta mbulojë shteti me ...

**Elona Kacani** . Shteti ka detyruar biznesin.

**Altin Tosku** . E kuptova këtë pjesë biznesi po ai e ka shumë të vështirë të punoje tek ai si biznes kurse kur punon tek shteti e ka sezonal e ka 3 muaj 4 muaj e ka shumë mirë punonjës in lart. Çertifikatën nuk e jap unë si biznes e merr vetë ai personi është personale është taman si patenta.

**Hekuran Xhani** . Të vijë kryetari herën tjetër t'i trajtojë këto probleme.

**Indrit Dedej** . Thjeshtë t'i flasë që të dalin në terren mos marrin rrogën kot, aq sa marrin.



**Elona Kacani** . Patjetër që po, drejtori këtu ishte pak më përpara.

**Mukades Gixhari** . Faleminderit Elona. Tani kemi diçka tjetër nga mbledhja e herës së kaluar. “Marrja e masave për një ndarje sa më efektive dhe të drejtë të regjistrimit të nxënësve në dy shkollat 9-vjeçare të qytetit Rrogozhinë”. Z. Fatmir Meçaj drejtori i arsimit pranë bashkisë Rrogozhinë.

**Fatmir Meçaj** . Atëherë ju përhëndes të gjithëve! Unë jam njohur me kërkesën që është për shkollën 9-vjeçare “Qamil Gjuzi” është?

**Mukades Gixhari** . Po.

**Fatmir Meçaj** . Kemi kërkuar vendimin e këshillit të asaj kohe që thonte që në shkollë regjistroheshe të gjithë ata që vinin nga banimi i asaj lagjeje të ndarë me lagje. Që për mendimin tim atëherë ka qenë numri i nxënësve shumë i lartë dhe vinin kushte kufizuese por kushte kufizuese nuk mund të vejmë. Ne e kërkuam atë vendim dhe nuk e disponojmë nuk e dimë ku është, e kërkuam dhe që ka shkuar në administrim në arshivë dhe nuk e gjejmë. Se për mendimin tonë ky vendim ka rënë poshtë. Në ç’kushte? Për faktin sepse atëherë bëhej dallim ndërmjet godinave “Qamil Gjuzi” me “George Soros” dhe unë kisha fëmijët e vegjël kërkova që t’i çoja tek “George Soros” se kishte kushte më të mira. Tani të dyja shkollat ma merr mendja që “Qamil Gjuzi” do jetë më e mirë tani se nuk ka përfunduar akoma. Dmth për sa i përket bashkisë kushtet e mirëmbajtjes, ofrimit të ndihmës për lëvizje dy, kushteve ekonomike të cilat ne kemi kërkuar gjithmonë . Familjet të cilat janë në nevojë na sillni emrat drejtorëve të shkollave që të ndihmohen financiarisht dhe përsëri e kemi bërëedhe këtë vit. Domethënë për sa i përket Bashkisë për ne ka humbur si vendim që do të thotë kjo i takon më shumë performancës së mësimit nuk ka të bëjë me Bashkinë. Atëherë më mirë drejtohuni drejtorisë Arsimore që ka të bëjë me mësimit. Që do të thotë në mendimin tim në qoftë se e shtjellojmë kështu do të thotë që nuk kanë aftësinë mësuesit që janë atje në performancë që të thithin fëmijë në regjistrim.

**Silvana Aliu** . The diçka të gabuar sapo e nise e the gabim.

**Fatmir Meçaj** . Ja po ta them ...

**Silvana Aliu** . Performancën nuk e vendos as opinioni i publikut as ...performancën mësuesit e japin njëlloj.



**Fatmir Meçaj** . A ta përsëris edhe njëherë? Po e jap më popullorçe fare Bashkia ndërhyt në mirëmbajtje godine i krijon kushte fëmijëve për të studiuar, ndërhyt nëse ai nuk ka mundësi për transport, ndërhyt nëse ai nuk ka kushte ekonomike, ndërhyt nëse ajo ka një presion ngërç familjar . Domethënë në këto gjëa shkolla i ka krijuar kushtet , janë të krijuara kushtet s’ mund të thotë askushi që jo. Atëherë i ngel në dorë që në qoftë se nuk shkon tek ajo shkollë i mbetet kjo performanca e mësimdhënies. Ma kuptove tani, nëse nuk isha i drejtpërdrejtë. Atëherë unë i kërkoj këshillit me mirësjellje me mirëkuptim që t’i drejtohet drejtorisë arsimore sepse mesa kam shikuar nga numri i nxënësve përcaktohet dhe numri i mësuesve ngarkesa drejtorë, nëndrejtorë numri ka rënë ju e dini shumë mirë. Godinat ne i kemi në përgjithësi të gjithë godinat e shkollave të reja dhe nuk kemi çfarë të themi në drejtim të Bashkisë. Atëherë për arsimin më e mira do të jetë të thirret në raport drejtoria e arsimit, ZVA-ja. Nëse keni ndonjë gjë ma thoni.

**Hekuran Xhani** . Shumë i saktë je.

**Silvana Aliu** . Jo nuk është fare i saktë. Mesa duket nuk paske informacion sepse në të gjitha bashkitë e Shqipërisë shkon në lagjen ku ka shkollën. Është përcaktuar nuk të lënë që nxënësi i lagjes tjetër të shkojë tek lagja tjetër, vetëm në Rrogozhinë ka ndodhur kjo.

**Fatmir Meçaj** . Ti tani më humbet intelektin tim se the një shprehje të gjitha të Shqipërisë por unë i kam fëmijët e mi në Tiranë i kam nipër mbesa në Tiranë dhe nuk shkon tek lagja por shkon ku i do qejfi është regjistruar.

**Silvana Aliu** . Jo, atëherë besoj se Desi është në dijeni me urdhër të ministres Nikolla kemi shkolla në Tiranë që janë në mbyllje u dha urdhër që nxënësi lagjes ...

*-Largohet nga mbledhja këshilltari z. Bajazit Thaçi në minutën e 44 të zhvillimit të mbledhjes.*

**Fatmir Meçaj** . Për arsye se ka kërkesa.

**Silvana Aliu** . Të dyja shkollat e Rrogozhinës janë ndarë me urdhër të Bashkisë nuk janë hapur se ka qenë urdhëri... atëherë Bashkia e hapi Bashkia të mbajë përgjegjësi. Sa për performancën, performanca e një personi për mua është një opinion që mund të kesh, ndërsa për mësuesit ta jap me garanci që janë mësues mbi 20 vjeçar dhe kanë shkëlqyer.

**Fatmir Meçaj** . Tani më fal të them një pyetje personale, ku jeni mësuese?

**Silvana Aliu** . Qamil Gjuzi.





**Fatmir Meçaj** . Prandaj e ngren problemin, ngreje performancën për vete dhe ma merr mendja do të vij në më shumë.

**Silvana Aliu** . Ku?

**Fatmir Meçaj** . Tek vendi jot.

**Silvana Aliu** . Unë klasën time e kam.

**Fatmir Meçaj** . Tani çfarë të them unë. Tani jo nuk kam informacion unë... Unë kam aq informacion sa ty ... është performanca e mësuesve. Ne aq godinë kemi sa na bie që klasat të jenë edhe me 15 veta.

**Indrit Dedej** . Unë i njoh kush janë mësuesit e Rrogozhinës.

**Alime Hoxha** . Të lutem nuk ke të drejtë t'i ofendosh asnjë. Jo mua asnjë tjetër nga mësuesit ...

**Silvana Aliu** . Përderisa po flet ai performancën...

**Fatmir Meçaj** . E kam nga prindërit, e kam nga performanca e mësueve tek të dyja shkollat e kam me shkrim.

**Hekuran Xhani** . Tani mesa kuptoj unë shkelet e drejta qytetare e njeriut ai mund të studiojë ku të dojë dhe si të dojë, se është shkelje kushtetuese.

**Fatmir Meçaj** . Unë i vë kushte kufizuese kur ka mbingarkesë. Por kur unë gjithë godinën e kam nuk e mbush dot me nxënës, si të vë kushte kufizuese?

**Alime Hoxha** . Mund të them diçka meqenëse jemi me drejtorin e arsimit. Tani e dini që në shkollën tonë është zhvilluar mësimi me dy turne gjatë vitit që u mbyll dhe aty ka nevojë për ndërhyrje nuk e di çfarë masash janë marrë nga Bashkia për të ndërhyrë tek ajo godinë.

**Fatmir Meçaj** . Kjo është pyetje e drejtë dhe ne e kemi dërguar dje në email dhe në whatsapp në grup të gjithë drejtorave të shkollave që të na sjellin ndërhyrjet që kërkojnë dhe vetëm shkolla e mesme e bashkuar Gosë ka sjellë asnjë nga shkollat e tjera nuk ka dërguar se ne po nuk na solle një kërkesë me shkrim ne nuk mund të bëjmë lëvizje për të blerë materiale në shërbime.



**Alime Hoxha** . Ajo shkollë ka nevojë për ndërhyrje.

**Fatmir Meçaj** . Atëherë fiksojeni datën sot deri më tani vetëm shkolla e mesme e bashkuar Gosë ...

**Alime Hoxha** . Atëherë ju kërkoni një letër nga drejtoria e shkollës.

*-Largohet nga mbledhja Këshilltari z. Hekuran Xhani min 47;40 i zhvillimit të mbledhjes.*

**Fatmir Meçaj** . E kemi kërkuar ka dy muaj dhe asnjë nuk ka sjellë dokumentacion sepse po nuk bëre kërkesën me shkrim ku duhet ndërhyrë nuk mund të ndërhysh të prishësh lekët. Unë dëgjoj se unë jam ekonomist dhe më vret veshin si kërkoni ju do harxhoj 5 lekë , po si u harxhonkan 5 lekë pa një letër ?! Tani bëni kërkesën na radhitni si zëra pastaj ka të tjera që bëjnë preventivat, bëjnë shpenzimet. A mos do ndonjë tender mos do ndonjë gjë tjetër? Si u bënkan këto gjëra në hava kështu unë nuk e marr përsipër. Nëse nga shkollat nuk sjellin një kërkesë me shkrim çfarë kërkojnë ne nuk ndërhyjmë në asnjë shkollë është ligjërisht, unë jam ekonomist nuk jam ... Vetëm shkolla e mesme e bashkuar Gosë ka sjell, të tjerët le të flasin. Nuk ke shkresë hapini emaillet hapini whatsapp-et nuk i keni sjellë nuk shërbehet kështu me fjalë hajde ulemi këtu e hajde ti themi njëri-tjetrit.

**Mukades Gixhari** . Z. Fatmir falemiderit. Tani të nderuar Këshilltarë nuk e kemi kuorumin e nevojshëm edhe z. Hekuran u largua, mbetemi 10 Këshilltarë kështu që mbledhja ... kemi disa problematika që kemi drejtorat por do t'i lejmë për mbledhjen e radhës. Kështu që mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur. Ju faleminderit.

-Këshilltarët përsëndesin njëri tjetrin.

## MBYLLET MBLEDHJA



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK**

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 10 : 00<sup>oo</sup> . (Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati në total 49 min ; 36 sek).

- Ky procesverbal mbyllet në faqen 19 (nëntëmbëdhjetë).

**Miratohet procesverbali :**

**Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :**

**Sekretari i Këshillit**

**Ervis Shera**